

## 1. Kontrolli

Në këtë menu do të gjeni informacion në lidhje me:


-Veprimet e mia

-Aprovimet në pritje

-Veprimet e kompanisë

### 1.1 Veprimet e Mia:

Këtu ju mund të gjeni të listuara të gjitha veprimet që ju si "maker"(personi që kryen veprimin) keni ekzekutuar dhe statusin e tyre. Nëse këto veprime janë aprovuar ose janë akoma në pritje për tu aprovuar:



The screenshot shows the BKT Business portal interface. The main content area is titled 'Veprimet e Kompanisë' and contains a table of transactions. A red box highlights the table, and a callout bubble points to it with the text 'Lista e veprimeve të kompanisë.' The table has the following data:

Tipi Veprimi	Data Proçesimit	Shuma	Statusi	Informacione të tjera	Ndryshimi i Fundit
<input type="checkbox"/> Mbyllje Autorizimi	10.02.2020	N/A	Aprovuar 10.02.2020		EMANUELA DEROMEMAJ
<input type="checkbox"/> Autorizim i Ri	10.02.2020 12:00:41	0.00 ALL	Aprovuar 10.02.2020	OSHEE	EVISA KUSHI
<input type="checkbox"/> Transferët mes Llogarive të Mia	30.01.2020 10:18:35	0.20 ALL	Aprovuar 30.01.2020	ISANAMED SHPK (TEST)	EVISA KUSHI
<input type="checkbox"/> Transferët brenda BKT	30.01.2020 10:19:46	0.15 ALL	Aprovuar 30.01.2020		EVISA KUSHI

Duke klikuar në butonin **Detaje** ju mund të merrni një informacion të detajuar në lidhje me veprimet e përzgjedhura

Duke klikuar në butonin **Arkivi** ju mund të kontrolloni veprimet tuaja për një afat të përcaktuar.

### 1.2 Aprovimet në Pritje:

Në këtë menu "**Aprovimet në Pritje**" ju mund të kontrolloni veprimet që persona të tjerë në kompaninë tuaj kanë kryer dhe janë në pritje të aprovimit tuaj.

Këto veprime mund të aprovohen ose të mos aprovohen nga ju.

- Për të realizuar këto duhet të ndiqni hapat e mëposhtëm:

**Aprovimet në Pritje**

Aprovimet në Pritje

Zgjidhni një veprim për ta anuluar ose aprovuar

Hedhësi	Data	Tipi	Shuma	Other Info
<input type="checkbox"/> EMANUELA DEROMEMAJ	10.02.2020 14:23:08	Transferitë mes Llogarive të Më	1.00 ALL	ISANAMED SHPK (TEST)
<input type="checkbox"/> GEJSA KUTROLLI	31.01.2020 16:32:25	Transferitë mes Llogarive të Më	10.00 ALL	ISANAMED SHPK (TEST)
<input type="checkbox"/> ALBANA RUSHITI	31.01.2020 15:27:03	Transferitë mes Llogarive të Më	2.00 ALL	ISANAMED SHPK (TEST)
<input type="checkbox"/> EMANUELA DEROMEMAJ	29.01.2020 15:45:48	Transferitë brenda BKT	0.10 ALL	

First 1 2 3 4 5 6 7 Last

Anullo Aprovo


Veprimet në pritje për autorizim. Kliko Aprovo për të përfunduar procesin ose Anullo për të fshirë veprimin.

Me qëllim të përfundoni të gjithë hapat ju duhet të vendosni të gjithë informacionin e mëposhtëm:

- Kontrolloni detajet e veprimeve që nuk do aprovoni si mëposhtë
  - Emri i maker-it (personi që kryen veprimin)
  - Data e procesit (data kur kryhet veprimi)
  - Tipi i veprimit
  - Shuma (e veprimit të realizuar)
  - Kodi i shumës (monedha e shumës)
  - Emri i bankës
  - Emri i degës
  - Emri i përfituesit
  - Llogaria e përfituesit
  - Përshkrimi


Më pas në pjesën e dytë janë specifikuar Detajet e Refuzimit si:

- Tipi i Refuzimit në të cilin duhet të përzgjedhim:
  - Nuk jam dakort/ jo fonde të mjaftueshme ose jashtë afatit kohor
  - Arsyeja e refuzimit /Veprimi nuk ka më kuptim
  - Pastaj klikoni mbi butonin **Kthehu** nqs doni të refuzoni këtë veprim



Për aprovim duhet të ndiqni hapat e mëposhtëm:  
 Me qëllim të përfundoni të gjithë hapat ju duhet të konfirmoni të gjithë informacionin e mëposhtëm:  
 Kontrolloni detajet e veprimeve që do të aprovoni si mëposhtë

- Emri i maker-it ( personi që kryen veprimin)
- Data e procesit (data kur kryhet veprimi)
- Tipi i veprimit
- Shuma (e veprimit të realizuar)
- Kodi i shumës (monedha e shumës)
- Emri i bankës
- Emri i degës
- Emri i përfituesit
- Llogaria e përfituesit
- Përshkrimi



Pastaj klikoni **Kthehu** nqs doni të refuzoni këtë veprim.


### 1.3 Veprimet e kompanisë:

Nëpërmjet këtij paneli "Veprimet e Kompanisë", ju mund të identifikoni të gjitha veprimet e realizuara nga llogaria e kompanisë nga çdo përdorues sipas të drejtave të përcaktuara në Vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

Për të identifikuar këto veprime ju duhet të ndiqni hapat e mëposhtme:

Nga lista e veprimeve ditore:

- Zgjidhni veprimin
- Pastaj klikoni mbi **Detaje** për të parë veprimin që dëshironi




## 2. Mbi Sigurinë(Personalizime)

Menunë Personalizime(Mbi Sigurinë) e gjeni në krye të faqes në anën e djathtë.


Në këtë menu, ju mund të veproni me Security Settings që janë listuar mëposhtë:

- Të drejtat e përdoruesit
- Ndryshim fjalëkalimi
- Pulla dixhitale
- Limitet e veprimeve




### 2.1 Të drejtat e përdoruesit

Në këtë panel ju mund të kontrolloni listën e përdoruesve të kompanisë në E-Banking dhe detyrimet e tyre:



Duke klikuar mbi një nga përdoruesit ju mund të merrni detaje të mëtejshme si të drejtat që posedon ky përdorues, limiti ditor i veprimeve, transaksionet që mund të kryejë.



## 2.2 Ndrysho Fjalëkalimin:


Në këtë faqe ju mund të ndryshoni fjalëkalimin tuaj që përdorni për t'u loguar në BKT Business E-Banking.

Për të kryer këtë proces, ju duhet të plotësoni fushat e nevojshme siç përmenden mëposhtë:

Zgjidhni kartën tuaj(numrat e kartës shfaqen pjesërisht të koduar).  
Në këtë panel ju mund të shikoni "Verifikim Pini", vendosni pinin tuaj dhe pastaj klikoni **Vazhdo** për të përfunduar këtë veprim.

Më pas duhet të plotësohen fushat e përmendura mëposhtë:

- shkruani fjalëkalimin tuaj aktual
- vendosni fjalëkalimin tuaj të ri
- vendosni fjalëkalimin tuaj të ri



### 2.3 Ndryshim i Pullës Dixhitale


Në këtë faqe mund të ndryshoni pullën dixhitale që shihni gjatë procesit të hyrjes.

Faqja është e përbërë nga dy pjesë:

- Në pjesën e parë shfaqet pulla dixhitale aktuale
- Në pjesën e dytë do të ketë një opsion kategorish me një listë me pulla dixhitale që


kanë lidhje me këtë kategori:

- Zgjidhni një llogari që ju preferoni
- Imazhi që i përket kësaj kategorie do të shfaqet në ekranin tuaj
- Zgjidhni një nga imazhet



## 2.4 Limitet e veprimeve

Në këtë seksion do mund të shikoni listën e gjithë veprimeve sëbashku me limitin ditor të veprimeve për kompaninë dhe userat (ju mund të shkarkoni informacionin në XLS dhe PDF).



## 2.5 Të Drejtat e Përdoruesit

Në këtë seksion ju do mund të kontrolloni të drejtat për të kryer veprime dhe të limitet e veprimeve për userat të cilët janë përdorues.

Duke zgjedhur një user të caktuar, ju shfaqet ekranin mëposhtë ku shprehen detaje mbi të drejtat e userit.

The screenshot shows a web application interface for managing user rights. At the top, there is a header with the logo 'KST Business' and a user profile 'Mirëdita EMANUELAJ'. The main content area is titled 'User Rights' and includes a 'Customer Information' section with a search bar for 'User No'. Below this is a 'List of Users' section with a search bar and export options for XLS and PDF. The table below lists users with their codes, names, and last update times. A pagination bar at the bottom of the table shows 'First', '1', '2', '3', and 'Last'. A 'Rights' button is located at the bottom right of the interface.

User Code	Customer Name	Last Updated
<input type="checkbox"/> 401546517	ALBANA RUSHITI	28.01.2020 10:00
<input type="checkbox"/> 401480964	PRANVERA BARDULLA	14.06.2018 14:44
<input type="checkbox"/> 425524464	GERALD ZENELI	23.01.2019 09:36
<input checked="" type="checkbox"/> 501864966	EMANUELA DEROMEMAJ	06.02.2020 16:33

Në këtë menu ju mund të zgjidhni të shikoni listën e gjithë veprimeve të kryera për kompaninë brenda një afati të përcaktuar nga ju.